



01/Nr. 5737/2024
Data : 10.07.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 18.06.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë e Financave), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027.
3. Rialokimi i mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare.
4. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- janë zhvilluar të gjitha procedurat sa i përket kornizës afat mesme buxhetore, është mbajtur dëgjimi publik . Përveç materialit të cilin ua kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- te shëndetësia primare totali stafit është 58, a është gabim që është shënuar apo kështu keni planifikuar. Te lista e projekteve kapitale qenka planifikuar renovimi i objektit të komunës kërkoj sqarim se për çfarë rregullimi bëhet fjalë. Te shpronësimi i parcelave te fabrika e ujit dhe te stadiumi i qyteti që do të thotë që edhe vitin e kaluar kemi pasur të planifikuara mjete. Te rruga Gorancë - Krivenik shihet që nuk ka vullnet nga ana juaj nga vetë planifikimi në shumë prej 15000 € sepse të gjithë e dimë se sa kushton ky projekt. Vendosija e ekranit për matjen e ndotjes së ajrit është projekt që vetëm po e bartni vit pas viti dhe nuk e realizoni. Te drejtoria e arsimit për çdo vit ka mjete por projekte nuk po realizoni, kërkoj sqarim se çka konkretisht do të investoni nëpër shkolla. A keni projekte konkrete për rregullimin e hapësirave turistike. Te drejtoria për kulturë keni shënuar hulumtimin e terreneve sportive për çfarë terene bëhet fjalë kur të gjithë e dimë se sa fusha sportiv i kemi. Nga lista e investimeve kapitale nuk shihet ndonjë projekt konkretë që i ndihmon qytetarët e komunës sonë. Si Lëvizje Vetëvendosje kërkoj që për lehonat shuma të rritet nga 100 € në 200 €. Projektit të mbikalimit te rruga Martirët Bushi t'i ipet prioritet dhe të ndahen mjete buxhetore. Te kategoritë e luftës kuroj që të trajtohen njëjtë sikur se klubet sportive. Kërkoj që të ndahet një shumë e mjeteve buxhetore për shtimin e kapaciteteve të ujit.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket stafit të shëndetësisë me qarkoren buxhetore e kemi numrin e aprovuar për vitin 2025 . Është një numër i rritjes së stafit ndërsa nga ana tjetër nuk kemi rritje të grantit specifik për t'i planifikuar mjetet. Nuk është gabim teknik nga ana jonë por kjo është nga niveli qendrorë sepse nuk jemi e vetmja komunë që kemi një rritje drastike të numrit të aprovuar të stafit por është në të gjitha komunat për shkak se e kemi diskutuar në kolegjum.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket renovimit të objektit të komunës kulmi i objektit është dëmtuar dhe duhet të ndërrohet komplet po ashtu duhet të bëhet fasadimi i disa zyrave dhe ka mundësi që në këtë projekt të përfshihet edhe vendosja e liftit. Për çështje të shpronësimit kemi bërë kërkesë në Qeveri dhe e kemi dërguar elaboratin dhe e kemi dërguar kërkesën për shpronësimin e parcelave për te fusha e futbollit, te fabrika e ujit dhe te qendra kulturore për shkak se këto parcele nuk janë në pronësi të komunës. Rruga Gorancë - Krivenik Ministria e Infrastrukturës ka ndarë mjetet financiare në shumë prej 400 000 € për tri vite dhe ne i kemi shtuar edhe 20 000 € në mënyrë që me përfunduar edhe një segment të kësaj rruge prej Gorancës deri te Pishat. Për vendosjen e ekranit për monitorimin e cilësisë së ajrit jemi interesuar por ka një kosto të larët afër 70 000 € dhe për shkak të mundësive buxhetore nuk besoj që edhe në vitin e ardhshëm që do të bëhet.

Hisni Luri thekson:- unë vetëm po i listojë disa prej investimeve kapitale te drejtoria e arsimit, renovimi i shkollës “Ilaz Thaqi”, renovimi i murit mbrojtës te paralelja në fshatin Seçishtë, rregullimi banjove te shkolla e mesme “Dardania “ rregullimi i shkollëve emergjente në tri shkollat , ndërrimi i dritareve te shkolla fillore “Kështjella e Diturisë”, suvatimi dhe ngjyrosja e shkollës “Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë. Në këtë vit edhe nëse duam me bërë ndonjë investim nuk mundemi për shkak se nxënësit ende janë në shkollë dhe ju e dini që e kemi problemin e kontratës kolektive dhe përmbaruesi po na i merr mjetet financiare . Planifikimet të cilat i kemi bërë mjetet financiare për kontratën kolektive kanë filluar të merren prej drejtorisë së arsimit

Arbenita Bajramaliu thekson:- për çështjen e terreneve sportive bëhet fjalë për mirëmbajtjen e sallave sportive.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- investime kapitale nuk kemi planifikuar në shëndetësi për shkak se nuk është e nevojshme. Jemi përfitues të donacioneve të ndryshme dhe na mbetet që të kujdesemi vetëm për mirëmbajtje.

Majlinda Kaloshi thekson:- sa i përket turizmit të pishat në fshatin Gorancë parashihet me u rregulluar.

Hyriete Isufi thekson:- është shënuar riorganizimi i ndërmarrjeve publike por nuk e di për cilat ndërmarrje bëhet fjalë pastaj kuadrat të reja për zjarrfikësit kërkoj sqarim se për çfarë kuadra bëhet fjalë. Çfarë plani keni për rritjen e të hyrave vetanake. Hapja e drejtimeve profesionale në shkollën e mesme dardania. Rregullimi i infrastrukturës së tregut ditorë në qytet dhe është mirë që me pas një vend. Te rritja e stafit në shëndetësi nuk mu dukë në rregull. Te arsimit shënon në dy pika emri i kordinatorëve të cilësisë . Është planifikuar asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta, pastaj asistent në arsimin para universitarë, kërkoj sqarim. Numri i këshilltarëve të karrierës me bazë në shkollë gjashtë deri dymbëdhjetë janë planifikuar dy, përsëri shënon numri i këshilltarëve të karrierës me bazë në shkollë gjashtë deri nëntë është një. Propozimet nga debati publik a keni mundur me infiltruar në programin e juaj.

Sevdi Dernjani thekson:- riorganizimi i strukturës së ndërmarrjeve publike është synim i kryetarit të komunës i cili e lenë ndër vite si opsion komisionin e aksionarëve, bordin e drejtorëve, kryeshefin ekzekutiv për me diskutuar për mundësinë e ristrukturimit.

Nexhmedin Daci thekson:- objektivat që parashihen në kornizë është programi politikë i Kryetarit të Komunës dhe sa mundet me u realizuar është çështje tjetër. Disa propozime të cilat janë dhënë janë të përfshira në projekte. Çështjen e tregut së bashku me drejtoreshën për zhvillim ekonomikë e kemi diskutuar çështjen e lokacionit dhe është te parcela afër komunës që është pronë e z.Refik Luri por duhet të bëhet shpronësimi.

Lindita Ballazhi thekson:- rritja e të hyrave është njëra prej objektivave të Kryetarit të Komunës dhe kemi marr disa veprime për rritjen e të hyrave siç është rikujtimi te qytetarët dhe publikimi në vebfaqe të komunës dhe në rrjetin social fesbuk për pagesën e tatimit në pronë si dhe kemi ofruar një mundësi për qytetarët që të bëjnë pagesën e tatimit në pronë me anë të kësteve përmes marrëveshjes. Rritja e të hyrave për vitet 2025 – 2027 është një projeksion që vjen nga qarkorja buxhetore dhe janë vlerësime të hershme. Numri i stafit në shëndetësi ka mundësi që është gabim teknik nga Ministria e Financave pasi që në çdo komunë ka rritje enorme të stafit në sektorin e shëndetësisë, ndërsa nga ana tjetër nuk ka ndryshuar buxheti në mënyrë që me i planifikuar ato pozita. Tabelat e grantit te arsimit janë marr nga qarkorja buxhetore dhe të njëjtat janë përfshirë në kornizën afat mesme buxhetore. Jemi duke punuar në procesverbalet për katër dëgjimet buxhetore dhe të gjitha propozimet e qytetarëve do të ju dërgohen si material shtesë për mbledhje të kuvendit të komunës dhe ju si asamble do ti shihni se cilat janë më me prioritet për komunitetin

Hisni Luri thekson:- sa i përket shkollës profesionale ju e dini që objektivat e kryetarit janë bërë në vitin 2021 dhe në vitin 2022 është shfuqizuar për shkak se nuk mund të bëhet shkolla edhe gjimnaz edhe shkollë profesionale kështu që e kemi të pa mundur për me realizuar këtë se nuk kemi hapësirë.

Xhevahir Dernjani thekson:- a është paraprë rruga nga policia e cila shkon deri te lagja Loku për shkak se kjo është një rrugë dytësore për fshatin Paldenicë

Nexhmedin Daci thekson:-për këtë rrugë edhe nënkryetari i komunës është interesuar por nuk kemi projekt të asaj rruge dhe ju e shini sa është buxheti por varet edhe prej kuvendit të komunës se a mundet me u realizuar kjo rrugë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU KORNIZA AFAT MESME BUXHETORE PËR VITET 2025-2027 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Rialokimi i mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe është e specifikuar në mënyrë të detajuar çështja e rialokimit të mjeteve financiare.

Sherif Berisha thekson:- kodet buxhetore të cilat po barten për rialokimin, cili është kodi më i vjetër që po bartet dhe pse nuk janë investuar mjetet ku ishin të alokuara.

Lindita Ballazhi thekson:- projekti më i vjetër nga i cili rialokohen mjetet është mjete të lira për bashkë investime i cili është kod i një projekti që planifikohet për çdo vit dhe është projekt për bashkë financime të ndryshme qoftë me IPA fonde apo me Ministri të ndryshme që do të thotë është projekt standard për çdo vit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RIALOKIMIN E MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE PASURI JOFINACIARE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- propozoj që të jetë sikur vitin e kaluar, a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIM PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- para disa dite kemi pasur festivalin mbarë kombëtarë dhe është mirë që të kemi një buxhet më të madh në drejtorinë e kulturës. Në Han të Elezit kemi artistë dhe në vitin e ardhshëm të jenë tri pika apo katër pika nga artistët vendas.

Sherif Berisha thekson:- flitet në opinion që drejtorja e arsimit donë me mbyll shkollë në fshatin Gorancë dhe Seçishtë . I kemi parë disa zarfa që janë dhënë atë ditë në festival dhe a është e vërtetë që keni ndarë mjete financiare me kesh për shoqëritë.

Hisni Luri thekson:- shkolla në fshatin Gorancë dhe në Seçishtë duhet ndoshta dekada për me u mbyll për shkak numrit të nxënësve sepse numri i nxënësve është shtatëdhjetë e nëntë kështu që me krahasuar me komunat tjera që me katër apo pesë nxënës mbajnë shkollë dhe nuk e kemi problem me mbajt deri edhe me dhjetë nxënës.

Arbenita Bajramaliu thekson:- janë dhënë disa çmime që nuk ka qenë shifër e madhe por simbolike dhe juria ka vendosur me i dhënë ato çmime për shkak të karakterit garues që e ka pasur festivali.

Hyriete Isufi thekson:- problem kemi pasur me çështjen e ujit edhe pse e ka në menaxhim kompania Bifurkacioni duhet komuna me u interesuar për këtë çështje. Po shohë edhe persona që po e lajnë edhe asfaltin duhet përfaqësuesit e kompanisë me i shikuar këto gjëra.

Arsim Dernjani thekson:- shumë herë i kam parashtruar ankesat te kompania Bifurkacioni por nuk e di se çka është problem me lagjen e juaj për shkak se shumica në lagje kanë ujë dhe nuk kanë pasur ankesa.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:10.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

